



## Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, 30.03.2021

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 26.03.2021 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "VECTOR SHPK" për aktivitetin: "Dezinsektimi hapësor i Komunes së Prishtinës" dhe me numër të prokurimit: **616 -21-497-211** nxjerr:

### V E N D I M

Refuzohet kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit ekonomik "VECTOR SHPK" e datës 26.03.2021 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Dezinsektimi hapësor i Komunes së Prishtinës" dhe me numër të prokurimit: **616 -21-497-211** kundër *Njoftimit për Kontrate të AK-se të datës 18.02.2021*, të publikuar në Platformën E Prokurimi.

1. Vërtetohet *Njoftimi për kontrate i Autoritetit Kontraktues të datës 18.02.2021 dhe AK-ja vazhdon aktivitetin sipas të njejt;*
2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

### A r s y e t i m

Operatori Ekonomik "VECTOR SHPK" me datë 26.03.2021 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Dezinsektimi hapësor i Komunes së Prishtinës" dhe me numër të prokurimit: **616 -21-497-211**.

Autoriteti Kontraktues, me datë 30.03.2021 ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka konstatuar si vijon:

-Pretendimi i parë është i pa bazuar sepse për shkak të rëndësive specifike nuk mund të kerkohen kritere që ju mundesojnë të marrin kontrate për shërbime OE-ik që nuk kanë njohuri as përvojë në këtë lëmi. Për këtë arsye edhe është dhënë mundësia ligjore e formimit të grupeve të OE-ik për pjesëmarrje në tenderim e që ju mundeson edhe kompanive me të vogla dhe pa përvojë që këto ta arrijnë në grup;

-Pretendimi i dytë është se Autoriteti Kontraktues ka vendosur kriter përjashtues lidhur me numrin e kontratave mund të trajtohet si i bazuar, por ju sqarohet se me datën 05.03.2021 është publikuar Njoftimi për korigjim ku është ndryshuar kjo kërkesë;

-Pretendimi tjetër lidhur me numrin e punetoreve poashtu është i pa bazuar pasi që numri i kërkuar paraqet minimumin e nevojshëm për realizim të suksesshëm të shërbimeve. Edhe në këtë rast ju dhe çdo OE-ik tjetër që ka interes për pjesëmarrje në aktivitet mund të shfrytëzojë të drejtën ligjore për të konkuruar në grup me ndonjë OE-ik tjetër. Lidhur me pesë punetoret e trajnuar për përdorim të produkteve biocide dhe paisjeve dezinfektuese ju sqarojmë se për shkak të teritorit të gjërë për kryerjen e shërbimeve është e domosdoshme që së paku aqë punetore të bëjnë sferkatjen me dorë, pa përdorim të automjeteve dhe secili prej tyre duhet të ketë njohuri të përdorimit të drejtë të preparatave dhe paisjeve. Poashtu edhe ata që bëjnë përgatitjen e preparatit për përdorim në automjete duhet patjetër të kenë njohuri të duhura lidhur me këtë.

Punetoret e kërkuar mund të jenë të çertifikuar nga cilido institucion brenda dhe jashtë vendit që është i akredituar për çertifikim dhe licencim në këtë lëmi.

Bazuar në sqarimet e dhëna për pretendimet tuaja u vendos si në dispozitiv.

**Këshilla juridike:**

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së.

Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit

